



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 4117/12 Prot.

Tiranë, më 14.9. 2020

Lënda: Kërkesë për fonde shtesë për vitin 2021

Z. OLTJON MUZAKA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

Në vijim të shkresës sonë nr. 4117/1 prot, datë 1.9.2020 kthim përgjigje tuajës nr. 13077/1 prot., datë 10.07.2020, dërgohet Udhëzimi Plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 "Mbi përgatitjet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023", si dhe në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", si dhe të Vendimit nr. 577, datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", po ripërsëritim kërkesat për fonde shtesë sa më poshtë:

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, në përmbushje te objektivave dhe prioriteteve të Qeverisë Shqiptare për periudhën afatmesme 2021-2023, kërkon shtesë fondi sa më poshtë:

- a) **Në programin buxhetor arsimit bazë (09120)**, për shkak të pandemisë së krijuar nga Covid 19, është e nevojshme që për vitin 2021 të planifikohet një shtesë fondi prej afro 650 milion lekë në zërin paga+sigurime shoqërore e shëndetësore, për rreth 1 000 (njëmijë) mësues me kontratë të përkohëshme, të cilët mund të nevojiten të zëvendësojnë mësuesit ekzistues për shkak të pandemisë, në rast të zgjatjes së saj edhe në vitin 2021.
Gjithashtu për të përmbushur objektivin e Qeverisë Shqiptare për shtrirjen e mësimin të gjuhës angleze nga klasa përgatitore/parashkollore, nismë e cila u reflektua edhe me shtesën e buxhetit me Aktin Normativ nr. 3/2020, kërkohet shtesë fondi nga viti 2021, shtesa e buxhetit duhet të shoqërohet edhe me shtesë të numrit të punonjësve mësimore.
- b) **Në programin buxhetor "arsimi i mesëm i përgjithshëm (9230)"** kërkohet shtesë buxheti prej të paktën 150 milion lekë për nxënësit të cilët mësojnë mbi 5 km nga vendbanimi për shkak të fatkeqësive natyrore ose rehabilitimit të objekteve ekzistuese.

- c) **Në arsimin parauniversitar (arsim bazë + arsimi i mesëm i përgjithshëm)** kërkohet shtesë buxheti në shpenzime kapitale/investime në shumën 900 milion lekë, i ndarë respektivisht 500 milion lekë në programin arsimit bazë (9120) dhe 400 milion lekë në programin arsimit të mesëm të përgjithshëm (9230), në zërin shpenzime kapitale, për të siguruar ndërtimin /rehabilitimin e objekteve shkollore të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje.
- Sjellim në vëmendje se buxheti i vitit 2020 i destinuar për këtë qëllim (FZHR 2020) u pakësua me Aktin Normativ në vitin 2020 dhe në këtë vit u financuan përmes Fondit Shqiptar për Zhvillimin, programi për rindërtimin, vetëm objektet shkollore të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, ndërkohë që objektet e tjera në zonat e paprekura nga tërmeti por që kanë nevojë emergjente për ndërhyrje nuk janë financuar në këtë vit.
- d) **Në programin buxhetor “Për Arsimin e Lartë 09450”**, në kuadër të “Paktit me Universitetet”, kërkohet një shtese fondi prej 800-900 milion lekë në zërin 604 “Transferte e pakushtëzuar”, për të përmbushur objektivat në IAL, duke rritur fondet “Granti për mësimdhënie”, ku përfshihen dhe bursat financiare të studentëve ku parashikohen të jenë më shumë se 12 000 studentë përfitues më një shumë prej 1 deri 1.1 miliard lekë.
- e) **Në programin buxhetor “Për Sportin dhe Rininë 08140”**, kërkohet një shtese fondi prej 250-300 milion lekë në zërin 604 “Transferte e pakushtëzuar”, për të përmbushur objektivat në kuadër të hyrjes në fuqi të ndryshimeve më të fundit të ligjit për sportin (*referuar ligjit 105/2020 datë 29.07.2020 “për disa ndryshime në ligjin 79/2017 “Për sportin” si dhe të ligjit 75/2019 “Për rininë”*).

Për sa më sipër, lutemi marrjen në konsideratë të kërkesave të MASR për shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2021.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Alqi KUSHI

